



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 759 / Prot.

Tiranë, më 1/8 /2013

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin "Spitali Multispecialistik Mjekësor Kirurgjikal Italo-Shqiptar Salus".

REKOMANDIM

Nr. 16 / datë 01/8 /2013

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Spitali Rajonal Vlorë".

KONSTATOVA

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit "Spitali Multispecialistik Mjekësor Kirurgjikal Italo-Shqiptar Salus" me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi Klinika Salus, për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Pacient".
- Siguria e të dhënave personale, masat e marra nga kontrolluesi Klinika Salus për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 21).

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi Spitali Salus, për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Pacientë".

Kontrolluesi "Spitali Salus" gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij në fushën e shëndetësisë, mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë "pacientë". Për këtë kategori subjektsh të të dhënave personale kontrolluesi ofron shërbime spitalore private, shtrime spitalore, analiza laboratorike, urgjenca etj. Kontrolluesi "Spitali Salus" për shërbimet që ofron, mbledh të dhëna personale dhe informacione për kategorinë "pacientë", nëpërmjet moduleve (formularëve të regjistrimit të pacientëve) të miratuara tip të cilat për çdo pacient që kërkon shërbim pranë këtij kontrolluesi.

Kështu gjatë kontrollit u këqyren dhe u administruan 2 module tip për kategorinë "pacientë", Të dhënat personale dhe informacioni personal që mbledhet për kategorinë "pacientë" në këto dy lloje modulesh konsiston në mbledhjen e; *emrit të pacientit, numri i identifikimit të shtetasit, kodi i pacientit, mbiemri , datëlindja, gjinia, vendbanimi, grupi i gjakut, Rhezusi, të*

dhëna mbi personin e interesuar, informacion mbi shtrimin, diagnozën klinike, mjekun e shtrimit, sëmundje të mëparshme etj.

Kontrolluesi “Spitali Salus” të dhënat e pacientëve i mbledh në sportelet e spitalit me anë të dy punonjëseve recepsioniste, ku pacienti dorëzon një dokument identifikimi dhe pasi bëhet regjistrimi i të dhënave në modul elektronikisht punonjësja një kopje ja jep pacientit i cili firmos në këtë modul. Moduli ka të përfshirë në përmbajtjen e tij disa pika që kanë lidhje me privatësinë e të dhënave të pacientëve, si dhe ka të cituar shprehimisht Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, konkretisht në pikën 3 dhe 4 të modulit. Në këtë modul nuk konstatohet një pikë e veçantë në lidhje me informacionin për transferimin në Itali të të dhënave personale të pacientëve për qëllime ekzaminimi në raste të veçanta me qëllim që pacienti të japi pëlqimin e tij me shkrim edhe për këtë pikë siç nënshkruan për trajtimin e të dhënave personale dhe sensitive që lidhen me gjendjen shëndetësore. Në një zyrë të veçantë ku kishin akses vetëm dy recepsionistet administroheshin modelet e pacientëve nëpër sirtar të ndarë sipas shkronjave të alfabetit.

Për sa i përket ligjshmërisë së të dhënave personale që kontrolluesi “Spitali Salus” mbledh për kategorinë “pacientë”, nga kontrolli që iu bë kategorisë së të dhënave dhe informacionit personal që kërkohet në këto module, në përputhje e zbatim të kriterëve që kërkojnë nenet 5-6 dhe në vijim të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, grupi i kontrollit administrativ nuk konstaton mbledhjen apo përpunimin e të dhënave jo në përputhje me ligjin apo të pa përshtatshme. Të dhënat kontrolluesi i grumbullon për qëllime specifike dhe të përcaktuara qartë në funksion të qëllimit.

Siguria e të dhënave personale, masat e marra

Grupi i kontrollit administrativ konstatoi se kontrolluesi “Spitali Salus”, ka në përbërje të vet departamentin e Teknologjisë dhe Informacionit (TI). Ky departament përfaqësohet nga një punonjës i cili ka të drejta administrative mbi sistemet fizike (hardëare) dhe informatike (softëare). Departamenti i TI-së administro:

- dhomën e serverave;
- sistemin e kontrollit të aksesit në ambientet fizike të kontrolluesit;
- sistemin e vëzhgimit dhe monitorimit nëpërmjet kamerave (CCTV);
- sistemin e kondicionimit të ambientit
- sistemin e sigurisë (alarmit)

Grupit të kontrollit administrativ ju vu në dispozicion dokumentacioni i kërkuar lidhur me funksionimin e këtij departamenti dhe u konstatua se:

- ka procedura për dhënie dhe kufizim aksesit për punonjësit lidhur me ambientet fizike si dhe sistemet informatike;
- ka procedura trajnimit për punonjësit;
- ka politika për mbrojtjen nga humbja, fshirja apo shkatërrimi i të dhënave dhe sistemeve;

Siguria e të dhënave personale, masat e marra nga kontrolluesi “Spitali Rajonal Vlorë” për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).

Grupi i kontrollit administrativ konstaton se kontrolluesi “Spitali Salus” mbledh dhe përpunon të dhëna personale dhe informacion personal për kategorinë “pacientë” në rrugë manuale nëpërmjet moduleve klinike dhe në rrugë elektronike.

Procedurat administrative për menaxhimin e të dhënave të pacientëve realizohen nëpërmjet aplikacionit "Med ARCIVER". Regjistrimi i pacientit realizohet pranë sportelit. Në sistem hidhen të dhënat bazë identifikuese të pacientit dhe në varësi të shërbimit (kurim, analiza, etj.) aksesit i kalohet doktorit apo departamentit përkatës. Në këtë sistem mund të hidhen manualisht të dhëna (analiza, raporte, diagnostikime etj.) të konstatuara në klinikë. Në këtë mënyrë, kontrolluesi "Spitali Salus" krijon një kartelë elektronike me të dhënat shëndetësore të pacientëve krahas kartelës fizike. Konstatohet se të dhënat në sistemin "Med ARCIVER" ruhen në vazhdimësi.

Aksesi në sistem "Med ARCIVER".

Konstatohet se në sistemin "Med ARCIVER" aksesit është i kufizuar në bazë të profilit, "emrit të përdoruesit" dhe "fjalëkalimit". Vetëm punonjësit e autorizuar të cilët operojnë brënda ambienteve fizike të "Spitalit Salus" kanë akses në sistem. Konstatohen nivele të ndryshme aksesit në varësi të profilit të punonjësit si: recepsion, mjek, infermier, laborant, etj. Çdo profili i jepet attribute të veçanta në sistem në funksion të veprimtarisë së tij. Menaxhimi i sistemit "Med ARCIVER" realizohet nga punonjësi i departamentit të Teknologjisë dhe Informacionit i cili është dhe "Administrator" i sistemit. Administratori i Sistemit disponon atributet për krijim profilesh, përdoruesish, dhënie attributesh etj.

Ruajtja e sistemeve qendrore dhe të dhënave personale

Konstatohet se kontrolluesi "Spitali Salus" për mbarëvajtjen e proceseve të punës ka ndërtuar një ambient teknik për vendosjen e serverave (Server Room). Ambienti ka akses të kufizuar nëpërmjet kontrollit elektronik të aksesit, çelësit dhe mbikëqyrje të hyrjes në këtë ambient me anë të sistemit CCTV. Konstatohet se ka masa të përshtatshme teknike për ruajtjen e temperaturës, lagështisë dhe zjarrit. Janë marrë masa për vazhdimësinë e punës në rast të shkëputjes së energjisë elektrike nëpërmjet pajisjeve UPS (uninterruptible power supply). Konstatohet se procedurat e ruajtjes së të dhënave dhe sistemeve janë në përputhje me politikën e "vazhdimësisë së biznesit". Backup realizohet në "tape" dhe në mënyrë "elektronike" dhe ruhet periodikisht në ambient të veçantë nga vendndodhja e serverit.

Shkatërrimi i dokumentacionit letër

Konstatohet se kontrolluesi "Spitali Salus", një pjesë të rëndësishme të proceseve të punës i realizon duke përdorur material letër. Nga intervistimi i punonjësit të Teknologjisë dhe Informacionit si dhe i specialistes së burimeve njerëzore u deklarua se kontrolluesi "Spitali Salus" nuk disponon një politikë për shkatërrimin e dokumenteve letër të cilat përmbajnë të dhëna personale të pacientëve, punonjësve etj.

Gjatë kontrollit administrativ u konstatuan dokumente të cilët përmbajnë të dhëna personale në ambiente lehtësisht të aksesueshme nga persona të paautorizuar (fotografi).

Ky konstatim përbën shkelje të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Kontratë me palë të treta

Grupi i kontrollit administrativ konstatoi se kontrolluesi "Spitali Salus" Tiranë, ka lidhur kontratë shërbimi me palë të treta në funksion të sigurisë dhe mbikëqyrjes së ambientit me anë të sistemit CCTV i cili realizon vëzhgim dhe monitorim të ambienteve fizike të kontrolluesit. Konstatohet se në kontratë nuk ka të përfshirë klauzola në funksion të konfidencialitetit për imazhet-videt e grumbullura në këtë sistem. Ky konstatim përbën

shkelje të nenit 27, 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar si dhe udhëzimit nr.19 mbi "Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi".

Përpunimi i të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV).

Konstatohet se kontrolluesi "Spitali Salus", mbikëqyr ambientet mbledh dhe përpunon të dhëna personale me anë të sistemit të video vëzhgimit dhe regjistrimit (CCTV). Kryesisht kamerat janë vendosur në korridore, recepsione dhe hollet e kontrolluesit. Kontrolluesi nuk ka rregulla të përcaktuara qartë për këtë mënyrë mbledhje dhe përpunim të dhënash personale në zbatim të Ligji Nr. 9887 datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe udhëzimit nr. 3 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video vëzhgimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme". Konstatohet se kontrolluesi ka vendosur tabela informuese për mbikëqyrjen e ambienteve me anë të sistemit të video vëzhgim-regjistrimit. Konstatohet gjithashtu se të dhënat imazhe-video ruhen për një periudhë 5 ditore nga dita e kontrollit

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të Kodit të Procedurave Administrative:

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 " Per mbrojtjen e të dhënave personale, kontrolluesi "Spitali Salus" në modul (formular i pacientit) duhet të përfshij edhe një pikë tjetër, pikën 6, në lidhje me informacionin për transferimin në Republikën e Italisë të të dhënave të pacientëve për qëllime ekzaminimi në raste të veçanta;
2. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme" të hartojë rregullore për qëllimin dhe mënyrën e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit CCTV;
3. Në zbatim të neneve 20, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa që në kontratat e lidhura me ofruesit e shërbimit për pajisjet dhe sistemet kompjuterike, të parashikohen dispozita dhe klauzola standarte për mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë dhe konfidencialitetin;
4. Detyrimet e rëndësishme të parashikuara në Rekomandim, të realizohen brenda një afati kohor prej 45 (dyzetëpesë) ditësh;
5. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
6. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues,veçanërisht në rastet e

përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

